# MONITORIM I GRANTEVE
## të biznesit social rinor

**Raport II**

# "Monitorimi i granteve të biznesit social rinor"

Mbështetur nga LevizAlbania

european youth association

LEVIZ Albania
Local Democracy in Action

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Ky Raport Monitorimi është pjesë e aktiviteteve të projektit "Monitorimi i granteve të biznesit social rinor", të realizuar nga European Youth Association dhe të financuar nga LevizAlbania.

**Realizuar nga:** European Youth Association
Adresa: Sheshi "Avni Rustemi" , Rr. Luigj Gurakuqi , P.89, Shk.A, K.9, Tiranë, Shqipëri

**Grupi i punës për këtë studim përbëhet nga:**
Migel Zallemi – Ekspert për shkrimin e raportit
Valmira Kosova – Eksperte për metodat e kërkimit
Ines Mulellari – Koordinatore projekti

Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave u realizua gjatë periudhës 01/09/2017 - 15/09/2017
Tiranë 2017

**Web: http://www.eya.org.al**
**E-amil: mzallemi@eya.org.al**
**Tel: 0697676576**

## Përmbajtja


1 Hyrje

1.1 Metodologjia

2 Gjetjet kryesore

3 Analiza dhe Rezultate

3.1 Transparenca e programit të granteve të biznesit social rinor

3.2 Efikasiteti i menaxhimit të programit të granteve të biznesit social

3.3 Qëndrueshmëria financiare e programit të granteve të biznesit social

3.4 Monitorimi i granteve

4 Rekomandimet kryesore

4.1 Sugjerime nga intervistat me grantmarrësit

5 Shtojca
- 5.1 Analizimi dhe statistika e intervistave me grantmarrësit
- 5.2 Formati i intervistës
- 5.3 Formati i fishës së raportimit
- 5.4 Infografe

# 1. HYRJE

European Youth Association në mbështetje të parimeve të mirëqeverisjes dhe transparencës financiare vendore, monitoroi grantet individuale të biznesit social rinor të akorduara nga Bashkia Tiranë në kuadër të projektit për Fondin e Programit të Nxitjes së Punësimit të miratuar me Vendim te Komisionit së Ndihmës Shtetërore Nr 68 datë 25.10.2016 dhe V.K.B nr 58 datë 30.12.2015 për "Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2016-2018 .

Objekt i monitorimit ishte procesi i shpalljes, konkurrimit, kontraktimit dhe ecurisë së granteve individuale, duke e konsideruar këtë projekt si një vendimmarrje lokale me karakter ekonomik dhe social nga ana e bashkisë Tiranë.

Vlen të theksohet se gjatë procesit të monitorimit ka pasur një nivel të kënaqshëm bashkëpunimi si nga ana e autoriteteve të bashkisë Tiranë ashtu edhe nga ana e grantmarrësve, ku pjesa më e madhe e të cilëve i është përgjigjur nëpërmjet regjistrimit audio intervistave tona. Disa nga intervistat janë kryer nëpërmjet telefonit për arsye se pjesa më e madhe e të intervistuarve kishin mungese disponibiliteti.

Në këtë raport do të paraqiten rezultatet e monitorimit për 20 aplikantë fitues, ku nga 20 fituesit e dytë, dy janë tërhequr për arsye personale ose proçeduriale edhe janë zëvendësuar me 2 grantmarrës poshtë vijës fituese. Rreth 60 % (12 biznese) e granteve janë akorduar për biznese Start-Up dhe 8 janë akorduar për biznese ekzistuese.

## 1.1 METODOLOGJIA

Metodologjia e përdorur në këtë projekt synon një monitorim objektiv dhe të paanshëm të granteve për nxitjen e punësimit. Tre fazat kryesore ku u përqendrua monitorimi jonë ishin procesi i përzgjedhjes, procesi i kontraktimit dhe qëndrueshmëria financiare e granteve.

European Youth Association përdori disa mjete të ndryshme për të arritur tek vlerësimi objektiv për indikatorë të veçantë të evidentuar në fillim të projektit. EYA dërgoi kërkesa për informacion për të marrë nga bashkia Tiranë dokumentacionin në lidhje me manualin e dhënies së granteve, ku vihet re se i njëjti manual si tek "Fondi i Gruas në Zhvillim" është përdorur edhe për 'Fondin e Biznesit Social Rinor', ku ndryshimi i vetëm ka qenë kriteri i moshës, 18 deri në 35 vjeç. Gjithashtu u monitorua veprimtaria e faqes online të bashkisë dhe stendave të saj fizike për të parë publikimet e fituesve dhe procedurat e shpalljes së granteve.

Instrumenti më i përshtatshëm dhe i rëndësishëm i përdorur në këtë studim është intervista me përfituesit e drejtpërdrejtë të granteve e cila pasqyron problematikën reale, nevojat dhe mundësitë që duhet të jepen për të qenë përfitues të suksesshëm.

# 2. GJETJET KRYESORE

**TRANSPARENCA**: Bashkia Tiranë nuk i ka bërë publike të gjitha fazat e programit, vlerësimet me pikë për secilin grantmarrës, përbërjen e komisionit përzgjedhës në faqen e saj zyrtare, stendën e bashkisë dhe publikimet në media. Për sa i përket pyetjes për transparencën e procesit, 6 prej të intervistuarve apo 35 % mendojnë se bashkia ka qenë shumë transparente. 47% e grantmarrësve mendojnë se bashkia ka qenë disi transparente por nuk janë informuar për të gjitha hapat e përzgjedhjes dhe është dashur të këmbëngulnin për të marrë informacionin e plotë.

**MOSHA:** Bashkia e Tiranës ka respektuar moshën e vendosur si kriter për fondin e granteve të biznesit social rinor. Për të aplikuar në këtë program duhet të plotësoje kriterin e moshës e cila varionte nga 18 vjeç deri në 35 vjeç. Vihet re gjithashtu se përfituesit i përkasin kryesisht moshës nga 21 vjeç deri në 32 vjeç.

**DISBURSIMI I FONDIT:** Bashkia Tiranë ka vonuar disbursimin e fondeve sipas fazave të parashikuara në kontratë, gjë që ka penguar ecurinë e zhvillimit të biznesit dhe ka vënë në vështirësi financiare grantmarrësit. Kontrata e nënshkruar me grantmarrësit ka datuar në muajin janar 2017 dhe fondin e parë bashkia e Tiranës e ka alokuar në gusht 2017. Fondi i  fazës së dytë është disbursuar vetëm për grantmarrësit që kanë dorëzuar faturat pranë zyrës së financës. Për grantmarrësit të cilët nuk e kanë përvetësuar akoma këstin e dyte, duhet të dorëzojnë pranë zyrës së financës faturat përkatëse, për të përfituar shumën e fazës së fundit të grantit.

**TRAJNIMI PËR MENAXHIMIN E GRANTIT:** Trajnimi që ka zhvilluar bashkia në lidhje me menaxhimin e grantit nuk ka qenë efikas. Sipas përgjigjeve të grantmarrësve ka pasur mangësi në informacion mbi regjistrimin e biznesit në QKB dhe zhvillimin e plan-bizneseve të tyre.

**QËNDRUESHMËRIA FINANCIARE:** Nga bizneset Up nuk u hap asnjë vend i ri pune, përveç të vetëpunësuarve përfitues. Nga bizneset ekzistuese nuk janë hapur vende të reja pune por granti është përdorur për zgjerimin e shërbimeve të ofruara nga biznesi i tyre. Grantmarrësit e bizneseve Start–Up janë disi optimistë për të vazhduar biznesin pas 6-mujorit të mbështetur nga fondi i bashkisë dhe mendojnë se vlera e këtij granti ishte më shumë një shtysë për të hapur biznes, se sa një sipërmarrje e qëndrueshme.
Grantmarrësit e bizneseve ekzistuese gjithashtu ndajnë të njëjtin mendim me grantmarrësit e bizneseve Start-Up, por ndryshe nga këta të fundit bashkia ka qenë një ndihmë për të blerë produktet, makineritë apo për të zgjeruar shërbimet që ofron biznesi përkatës.

**MONITORIMI DHE KONTRATA:** Grantmarrësit raportojnë se bashkia Tiranë ka kryer çdo muaj kontrollet fizike dhe financiare tek bizneset e tyre për të parë ecurinë dhe problematikat. Sipas grantmarrësve të intervistuar kushtet e kontratës janë zbatuar vetëm nga ana e tyre duke respektuar çdo nen të kontratës, ku vlen të theksohet se NIPT-i i çdo biznesi Start-UP është bërë aktiv pa kaluar fondi i parë i grantit. Bashkia nuk i është përmbajtur të gjitha neneve që përcaktojnë detyrimet e saj kontraktore si grantdhënëse, sidomos pjesës së alokimit të fondeve sipas afateve të kontratës.

**DISPONIBILITETI DHE PROFILI I GRANTMARRËSVE:** Nga 20 grantmarrësite fazës së dytë, 5 prej tyre nuk figurojnë të regjistruar pranë QKB. Gjatë intervistave por dhe njoftimit paraprak me grantmarrësit, 3 apo 18% e grantmarrësve kanë refuzuar të japin intervistë me justifikimin se nuk kanë kohë në dispozicion. Vlen të thkesohet se, sipas të dhënave të administruara nga EYA, tre grantmarrësit të cilët nuk i janë përgjigjur intervistës janë pjesë e forumit rinor të Partisë Socialiste, FRESSH.

# 3. ANALIZA DHE REZULTATE

## 3.1 Transparenca e programit të granteve të biznesit social rinor

Nga rezultatet e marra prej kërkesave për informacion dhe monitorimit me fisha raportimi rezulton se:
Bashkia Tiranë e ka përdorur faqen e saj zyrtare dhe mediat sociale për shpalljen vetëm të fazës së aplikimit, jo për fazat e tjera të projektit.

Bashkia Tiranë nuk ka bërë publike në faqen e saj zyrtare ose mediat sociale fondin total të grantit të shpërndarë së bashku me shpenzimet operacionale, si dhe nuk ka shpallur fazat e njëpasnjëshme deri në publikimin e fituesve.

Bashkia Tiranë nuk ka bërë publike gjithashtu në faqen e saj të internetit apo media pikët e marra nga secili fitues apo jo fitues, si dhe emrat dhe përbërjen e komisionit përzgjedhës të tyre.

Nga intervistat me grantmarrësit në lidhje me transparencën e programit të bashkisë vërejmë se:

Nga përgjigjet e pyetjes 3 e cila thekson mënyrën sesi janë vënë në dijeni të këtij fondi të dhënë nga bashkia e Tiranës, shohim se 59% e tyre janë vënë në dije nga faqja zyrtare e bashkisë Tiranë (facebook, media e shkruar). 17 % prej tyre janë vënë në dijeni për shpalljen e grantit nga të afërmit e tyre ndërsa njw individ, apo 6% e grantmarrësve është informuar nga stafi i bashkisë, pasi ai bën pjesë në forumin e individëve me aftësi të kufizuar.

Tetë prej grantmarrësve të intervistuar i kanë drejtuar pyetje ndaj bashkisë në periudhën e aplikimit. Përgjigja e punonjësve të bashkisë sipas tyre ishte në kohë reale dhe mjaft ndihmuese për adresimin e pyetjeve të drejtuara stafit për procesin e aplikimit. Pjesa tjetër e të intervistuarve raporton se procesi i aplikimit online ishte i lehtë dhe i qartë ndaj edhe nuk kishte shumë vend për të drejtuar pyetje. 35% e të intervistuarve nuk kanë pasur pyetje drejtuar bashkisë Tiranë, pasi sipas tyre thuhet se dokumentat që u janë dërguar me e-mail kanë qenë mese të kuptueshme.

Në total procesi i aplikimit zgjati 2 muaj duke filluar në muajin nëntor të vitit 2016. Kësti i parë i grantit i ka kaluar përfitueseve në muajin Shtator 2017 dhe kësti i dytë është disbursuar për çdo grantmarrës që ka dorëzuar faturat e shpenzimeve pranë zyrës së financës. Në një mendim unanim të intervistuarit janë shprehur se një nga ngërçet kryesore ka qenë vonesa e disbursimit të parave.

## 3.2 Efikasiteti i menaxhimit të programit të granteve të biznesit social rinor

**Nga monitorimi rezulton se:**

- Ekipi i bashkisë Tiranë nuk ka respektuar të gjitha afatet kohore sipas shpalljes fillestare, ku problem mbeten vonesat me disbursimin e fazave për grantmarrësit.
- Bashkia e Tiranës ka zhvilluar gjithësej një trajnim me përfituesit e grantit Trajnimi ka qenë efikas nga ana teorike por nga ana praktike grantmarrësit kanë pasur nevojë për më shumë mbështetje dhe orientim. Problemi më i madh ka qenë regjistrimi në QKB dhe vetëdeklarimi.

Një prej të intervistuarve shprehet se trajnimi ishte ndërveprues, por ishte hasur në vështirësi pasi nuk kuptonte terminologjinë e përdorur në trajnim, duke theksuar se do ishte më mirë që trajnimet të bëheshin të ndara (bizneset Start-Up nga ato ekzistuese). Një tjetër i intervistuar u shpreh se trajnimi ishte efikas dhe ndihmues sidomos duke dhënë ide të reja për zgjerimin e biznesit.

Një problem i identifikuar me strukturimin e trajnimit ishte fakti se nuk ishte marrë parasysh niveli paraprak i njohurive të pjesëmarrëseve. Për rrjedhojë, një pjesë e të intervistuarve u shprehën se trajnimi ishte më tepër teorik dhe përmbante shumë pak informacione nga ana praktike.

Grantmarrësit theksojnë se gjatë shkrimit të projekt-biznesit kanë hasur probleme me përshtatjen e idesë së tyre me tregun duke e menduar të nevojshme dhe të rëndësishme përfshirjen e kësaj problematike në trajnimet e mëtejshme.

78% e të intervistuarve nuk kanë pasur probleme me regjistrimin e bizneseve në QKB. Vetëm 3 prej tyre që kanë hasur probleme që lidhen me mungesën e informacionit për procedurat që duhet të ndiqnin si dhe për vetëdeklarimin që duhet të kryenin.

Vemë re se 76% e grantmarrësve nuk kanë parashtruar ndonjë ankesë ndaj bashkisë gjatë procedurës së aplikimit për grantin. Për ata grantmarrës që kanë parashtruar ankesa (6%) ndaj bashkisë, arsyet kryesore lidhen me aspektet administrative të aplikimit. Theksohet vonesa e disbursimit të fondit të parë, ku grantmarrësit shprehen se në momentin kur granti u alokua çdo shpenzim ata e kishin mbuluar vetë. Një prej tyre shprehet se ky fond ka qënë një nismë për zgjedhjet 2017, për shkak të vonesës së grantit.

## 3.3 Qëndrueshmëria financiare e programit të granteve të biznesit social rinor

Një nga aspektet më të rëndësishme të efikasitetit të grantit është qëndrueshmëria financiare dhe aftësia e tij për të mundësuar ngritjen e një biznesi të suksesshëm. Pjesa më e madhe e të intervistuarve raporton se, ndërkohë që financimi ka qenë i rëndësishëm për nisjen dhe mbajtjen e biznesit të tyre, në vetvete financimi ka qenë i pamjaftueshëm për të krijuar qëndrueshmëri.

**Nga monitorimi rezulton se:**

- Nuk ka pasur vende të reja të pune të krijuara. Për grantmarrësit ekzistues ka shërbyer vetëm për zgjerimin e shërbimeve të ofruara në biznes, ndërsa për grantmarrësit Start-Up më shumë ka qenë një shtysë për të realizuar ëndrrën e tyre edhe pse jo për të sjellë një risi në Shqipëri.
- Bizneset ekzistuese kanë qenë më fitimprurës për arsye se nuk u është dashur të krijojnë klientelë të re por kanë shtuar vetëm shërbimin. Ndërsa bizneset Start-Up kanë qenë në një sfidë për sa i përket vendit që duhet të zgjidhnin për të hapur biznesin e tyre ku 4 prej grantmarrësve u është dashur të ndërrojnë disa herë selinë ku njëri prej tyre ka hasur probleme me marrjen e lejës për hapësirat publike, ku shprehet se kërkon ndihmën e bashkisë për ta ndihmuar.

Tek bizneset Start-Up vlerësohet e vështirë vazhdueshmëria pas kalimit të gjashtë muajve të mbështetjes. Sipas të intervistuarve granti i bashkisë ka qenë një shtysë për të hapur biznes se sa një mundësi për të krijuar një biznes të qëndrueshëm financiarisht në kohë. Vështirësi që shihet tek bizneset Start-Up janë pagesat që duhet të bëjnë me buxhetin e tyre para se të marrin fondin, kjo për arsye të dorëzimit të faturave dhe më pas të alokimit të fondit.

**10 prej të intervistuarave** se institucionet shtetërorë duke përfshirë edhe bashkinë kanë shumë probleme për mbledhjen e faturave apo dorëzimin e dokumentave. Ata shprehen se ka shumë burokraci dhe vonesa në kthimin e përgjigjeve.




## 3.4 Monitorimi i granteve

Përveç financimit të ideve për sipërmarrësit, bashkia ka rol të rëndësishëm edhe në monitorimin e vënies në jetë të këtyre ideve. Bashkia ka kryer monitorim të vazhdueshëm pranë grantmarrësve duke iu përmbajtur pikave të kontratës. Në momentin e mbarimit të kontratës 6 mujore bashkia do kryejë një monitorim, si dhe monitorime çdo tre muaj dhe më pas dy here ne vit. Gjithashtu ata pranojnë se raportojnë gjithmonë pranë sektorëve përkatës në bashkinë Tiranë për ecurinë e bizneseve. Përfituesit janë kontaktuar nga punonjësit e bashkisë në mënyra të ndryshme, nga telefonatat për të kontrolluar ecurinë e biznesit, kontrolle në terren për të kontrolluar mënyrën e zbatimit të grantit dhe për të mbledhur të dhëna mbi aspekte të ndryshme të suksesit financiar të biznesit.

Nga përgjigjet e të intervistuarve shohim se 59% e tyre kanë kontakte të shpeshta me bashkinë. Intervistuesit theksojnë se kanë kontakte me stafin e bashkisë në momentin e monitorimit nga ana e tyre si dhe në momentin kur ju duhet të raportojnë ecurinë e bizneseve. Vëmë re se vetëm 17% e të intervistuarve kanë kontakte disi të shpeshta pasi kanë qenë të qartë, nuk kanë pasur pyetje ata thjesht kanë raportuar ecurinë e bizneseve të tyre. Vlejmë të theksojmë se 6% e tyre kanë kontakte shumë të shpeshta duke iu drejtuar bashkisë me pyetje por edhe konsultime për veprimet financiare gjatë raportimit të ecurisë së bizneseve.

# 4. REKOMANDIMET KRYESORE

**TRANSPARENCA E FAZAVE TË PËRZGJEDHJES:** Për të nxitur tranparencën e programit të granteve, Drejtoria e Nxitjes së Punësimit pranë bashkisë Tiranë duhet të bëjë publike të gjitha fazat e procesit të grantdhënies, të njohë konkurrentët me përbërjen e bordit vlerësues si dhe të shpallë tabela pikëzuese për fituesit dhe humbësit. Konkursi publik me të përzgjedhurit e fazës së parë, referuar modelit të LëvizAlbania do t'i shërbente rritjes së besueshmërisë së procesit. Sugjerohet përfshirja e medias, organizatave të shoqërisë civile dhe përdorimi i rrjeteve sociale në promovimin e thirrjeve të radhës dhe bizneseve Start-Up të financuara nga grantet e bashkisë Tiranë.

**STIMULIMI I BIZNESEVE:** Bashkia Tiranë duhet te rishohë programin në disa aspekte, siç janë rritja e shumës së grantimit, mbështetja e vazhdueshme për grantmarrësit e suksesshëm dhe respektimi i kushteve kontraktore, veçanërisht disbursimit të fondeve në kohë, kjo për të stimuluar biznese të reja të qëndrueshme financiarisht.

**PROMOVIMI:** Bashkia Tiranë duhet të marrë parasysh organizimin e aktiviteteve promovuese për bizneset e mbështetura nga granti i sipërmarrjes rinore për të rritur mundësinë e krijimit të klientelës nga ana e tyre. Kjo mund të realizohet edhe nga aktivitete që nuk organizohen posaçërisht për grantmarrësit, por t'u jepet mundësia e promovimit edhe atyre.

**BURIMET E KUFIZUARA FINANCIARE:** Sipas të gjithë grantmarrësve të intervistuar, duke marrë parasysh burimet e kufizuara financiare, një zgjidhje që propozojmë është ulja e numrit të fituesve të grantit dhe rritja e shumës së financimit për fituesit ose bashkëpunimi me institucione financiare nëpërmjet një marrëveshje mes bashkisë dhe tyre për të rritur masën e financimit.

**FAVORIZIMI I ANETAREVE TE PARTIVE POLITIKE:** Vihet re se disa nga grantmarrësit janë aktivë publikisht në parti dhe forumet rinore politike. Në këtë kuadër propozojmë një filtër përzgjedhës për të parandaluar konfliktin e interesit dhe favorizimin për shkak të përkatësisë politike.

## 4.1 Sugjerime nga intervistat me grantmarrësit

Grantmarrësit e intervistuar paraqitën një sërë sugjerimesh dhe kritikash për përmirësimin e procesit të grantimit. Një prej rekomandimeve që dolën nga intervistat është mbështetja e vazhdueshme nga ana e bashkisë për bizneset që u krijuan.

Një mënyrë tjetër për nxitjen e bizneseve është shfrytëzimi i aktiviteteve të ndryshme të bashkisë për të ftuar dhe angazhuar bizneset që ajo mbështet. Në këtë mënyrë mundësohet reklamimi i sipërmarrjeve të financuara dhe njëkohësisht edhe i punës së bashkisë dhe sukseset që ato kanë arritur. Disa prej të intervistuarve shfaqën pakënaqësi për angazhimin e bashkisë në promovimin e këtyre bizneseve të reja. Për rrjedhojë, organizimi i aktiviteteve promovuese, përdorimi i medias televizive dhe asaj sociale për të promovuar këto biznese mund të jetë ndihmë për garantimin e qëndrueshmërisë financiare të tyre.

Një prej problemeve kryesore të identifikuara nga grantmarrësit e intervistuar janë vonesat në disbursimin e pagesave. Është e rëndësishme për një pjesë të grantmarrësve që janë financuar që të marrin në kohë këstet e pagesave në mënyrë që të përballohen shpenzimet e ndryshme të biznesit. Një pjesë e sipërmarrëseve kanë shpenzuar mjaft nga burimet e tyre financiare për të përballuar kostot e hapjes së një biznesi të ri. Në këtë mënyrë, do të ishte e nevojshme vendosja e një sistemi më korrekt pagesash që të shmangen vonesat e tej zgjatura nga ana e bashkisë dhe të rritet efiçensa e grantit.

Një tjetër sugjerim që u ngrit nga një pjesë e mirë e të intervistuarve ishte masa e financimit. Rritja e shumës së financimit duket e domosdoshme për krijimin e një qëndrueshmërie më të lartë për bizneset e reja të nisura nga grantmarrësit. Duke marrë parasysh burimet e kufizuara financiare një zgjidhje që propozojmë është ulja e numrit të fituesve të grantit dhe rritja e shumës së financimit për fituesit. Vendosja e kritereve më korrekte për garantimin e vazhdimësisë së biznesit mund të bëjë të mundur përzgjedhjen vetëm të ideve më të mira e që sjellin risi.
Trajnimi i zhvilluar nga bashkia ishte i rëndësishëm për pothuajse të gjithë grantmarrësit e intervistuar.

Megjithatë nga përgjigjet e dhëna ishte e dukshme se niveli fillestar i njohurive ishte mjaft i ndryshëm, çka e bën të domosdoshëm ndryshimin e mënyrës se si organizohet trajnimi. Trajnimi që ka zhvilluar bashkia në lidhje me menaxhimin e grantit nuk ka qenë efikas plotësisht, sipas përgjigjeve të grantmarrësve duke pasur mangësi në informacionin mbi regjistrimin e biznesit dhe zhvillimit të plan biznesit të tyre. Grantmarrësit Start-UP theksojnë se bashkia duhet t'i japë më shumë rëndësi pjesës së buxhetit duke ofruar kosulencë financiare.

Grantmarrësit shprehen se bashkia duhet të jetë një nga instancat vendimmarrëse në përzgjedhjen apo piketimin e vëndit për të nisur një biznes. Kërkohet një liri më shumë për dhënien e lejes për hapësirat publike duke pasur parasysh se këo janë biznese të financuara nga bashkia Tiranë. Nga intervistat u bë e qartë së shpesh kushtet e kontratës nuk janë zbatuar nga bashkia, ndërkohë që përfituesit e grantit duhet ta zbatonin atë me përpikëri. Në këtë kuadër bëhet i nevojshëm rishikimi i afateve kohore të kontratës dhe detyrimet e të drejtat e palëve të përfshira në mënyrë që këto të jenë të barabarta ndërmjet bashkisë së Tiranës dhe përfituesve të grantit.

# 5. SHTOJCË

## 5.1 Analizimi dhe statistikat e intervistave me grantmarrësit

**SQARIM:**

- Përgjigjet për çdo pyetje janë të listuar nga 1-shi tek 5-a. Në grafik do të shfaqen totalet e zgjedhjes së çdo përgjigje dhënë nga 17 të intervistuarit.
- Theksojmë se alternativa nr. 4 ose nr. 5 janë shtuar si rezultat i tre përfituesve të cilët refuzuan të intervistoheshin dhe atyre të cilën nuk kanë shprehur mendim për pyetjen.
- Për përgjigjet të cilat kanë totalin 0 (zero) do të thotë se asnjë nga grantmarrësit nuk e ka zgjedhur si opsion përkatës.

### Pyetja 3.

**Si u vutë në dijeni të granteve të bashkisë?**

**1.**Faqja zyrtare e Bashkisë
**2.**Nga të afërmit tuaj
**3.**Nga stafi i bashkisë Tiranë
**4.**S'ka përgjigje




Nga përgjigjet e pyetjes 3 shohim se 59% e tyre janë vënë në dijeni të thirrjes për aplikim në këtë program nga faqja zyrtare e bashkisë Tiranë (facebook, media). 17 % e grantmarrësve janë vënë në dijeni për aplikimin në këtë grant nga të afërmit e tyre dhe 6% e grantmarrësve, janë informuar nga stafi i bashkisë. 18% e grantmarrësve kanë refuzuar të japin një përgjigje.

## Pyetja 4.

**Sa transparente ishte bashkia gjatë procesit të aplikimit?**

1. Shumë transparente
2. Transparente
3. Jo shumë transparente
4. Aspak transparente
5. S'ka përgjigje




Gjashtë prej të intervistuarve mendojnë se bashkia ka qenë shumë transparente, pra 35% prej tyre. 47% e gratmarrësve mendojnë se bashkia ka qenë transparente dhe këtu vlen të theksojmë përgjigjet e disa prej grantmarrësve të cilën janë shprehur se nuk informoheshin për të gjitha hapat e përzgjedhjes por duhet të këmbëngulnin për të marrë informacionin e duhur.

## Pyetja 5.

**Gjatë procesit të aplikimit a i jeni drejtuar bashkisë me pyetje/sqarime mbi aplikimin?**

1. Po
2. Jo
3. Tjetër
4. S'ka përgjigje

**5.a.** Nenqoftese "Po" për sa kohë ju ka kthyer përgjigje bashkia Tiranë?
**5.b.** A ishte ndihmuese asistenca e bashkisë ?




Tetë prej grantmarrësve të intervistuar i kanë drejtuar pyetje bashkisë në periudhën e aplikimit. Përgjigja e punonjësve të bashkisë sipas tyre ishte në kohë reale dhe mjaft ndihmuese për adresimin e pyetjeve të drejtuara ndaj stafit për procesin e aplikimit. 35% e të intervistuarve raporton se procesi i aplikimit online ishte i lehtë dhe i qartë ndaj edhe nuk kishte shumë vend për të drejtuar pyetje ndaj stafit të bashkisë.

## Pyetja 6

**Sa kohë zgjati i gjithë procesi i aplikimit?**

Nga grantmarrësit është pohuar se procesi i aplikimit deri në periudhën që janë shpallur fitues ka zgjatur afërsisht 2 muaj. Në momentin që individët kanë dorëzuar dokumentat e nevojshëm në fillim të aplikimit, kanë hasur probleme me pritjen në rradhë pranë sportelit të shërbimit në bashkinë Tiranë duke sugjeruar shtimin e me shumë sporteleve.

## Pyetja 7

**Sa trajnime u zhvilluan gjithsej? Sa efikase ishin trajnimet e bashkisë?**

Nga përgjigjet e grantmarrësve vërejmë se është zhvilluar vetëm një trajnim me tre tema të ndryshme, të shtrira në periudhë tre ditore secila. Trajnimi që ka zhvilluar bashkia në lidhje me menaxhimin e grantit nuk ka qenë efikas. Sipas përgjigjeve të grantmarrësve, ata kanë pasur mangësi në informacion mbi regjistrimin e biznesit në QKB si dhe zhvillimit të plan-bizneseve të tyre. Grantmarrësit kërkonin një trajnim më specifik dhe praktik.

## Pyetja 8

**A keni pasur ankesë ndaj qasjes së bashkisë me procesin?**

1. Po
2. Jo
1.1. Nëse "Po", pse?
4. S'ka përgjigje




76%, nuk kanë parashtruar ndonjë ankesë ndaj bashkisë gjatë procedurës së aplikimit për grantin dhe më pas. Për ata grantmarrës që kanë parashtruar ankesa(6%) ndaj bashkisë, arsyet kryesore lidhen me aspektet administrative të aplikimit. Për shembull, një prej tyre përmendi vonesat dhe kërkesat e ndryshme për dokumentacion që i duhej të parashtronte, si dhe fakti që një pjesë e mire e këtyre dokumentave të lëshuar nga banka bëheshin kundrejt një pagesë, për të cilën bashkia ose nuk ishte në dijeni ose nuk e kishte parashikuar më herët.

## Pyetja 9.

**Cila është fusha e biznesit tuaj?**

Duke iu përgjigjur pyetjes pasuese vërejmë se fusha e biznesit për çdo grantmarrës është e ndryshme. Më poshtë do të gjeni të listuara bizneset përkatëse: ▶ Restorant ▶ Shërbim design ▶ Servis automjetesh ▶ Catering, restorant i lëvizshëm. ▶ Qendër sociale për personat me aftësi të kufizuar. ▶ Shërbim mbi gjuhën e shenjave. ▶ Organizim eventesh. ▶ Dhënie shërbime audio me qera. ▶ Tregti me pakicë të artikujve ushqimorë. ▶ Studio artistike fotografie

## Pyetja 10.

**A është e mjaftueshme shuma e investuar nga bashkia Tiranë për sigurimin e qëndrueshmërisë financiare?**

Bizneset ekzistuese kanë qënë më fitimprurës për arsye se nuk u është dashur të krijojnë klientelë të re por kanë shtuar vetëm shërbime. Ndërsa bizneset Start up kanë qenë në një sfidë të vërtetë në lidhje me fitimet. Shumë herë u është dashur të paguajnë vetë pjesën plotësuese për blerjen e produkteve. Tek bizneset Start-Up vlerësohet e vështirë vazhdueshmëria pas kalimit të gjashtë muajve të mbështetjes. Sipas të intervistuarëve granti i bashkisë ka qënë një shtysë për të hapur biznes më shumë se sa një mundësi për të krijuar një biznes të qëndrueshëm financiarisht në kohë. Bizneset Start-Up ndryshe nga ato ekzistuese vuajnë mungesën e promovimit dhe të klientelës.

Bizneset vlerësojnë bashkinë për nismën por edhe për iniciativën që u ka mundësuar për krijimin e një biznesi të ri, por ata theksojnë se këto biznese që krijohen apo zgjerohen me fondet e bashkisë duhet të mbështeten vazhdimisht. Kjo ju siguron atyre një qëndrueshmëri financiare por edhe motivim për të zgjeruar më shumë shërbimet ndaj qytetarëve të Tiranës.

## Pyetja 12

**A keni kontakte të shpeshta me bashkinë?**

1. Shumë të shpeshta
2. Të shpeshta
3. Disi të shpeshta
4. Nuk kemi kontakte
5. S'ka përgjigjeje




Nga përgjigjet e të intervistuarve shohim se 59% prej tyre kanë kontakte të shpeshta me bashkinë. Intervistuesit theksojnë se kanë kontakte me stafin e bashkisë në momentin e monitorimit nga ana e tyre si dhe në momentin kur i'u duhet të raportojnë ecurinë e bizneseve. Vihet re se vetëm 17% e të intervistuarve kanë kontakte disi të shpeshta me bashkinë. Vlen të theksojmë se 6% e tyre kanë kontakte shumë të shpeshta me bashkinë.

## Pyetja 13

**A mund t'i drejtoheni bashkisë me pyetje/shqetësime në lidhje me biznesin tuaj?**

Unanimisht shprehen se stafi i bashkisë është i hapur për pyetje apo shqetësime të tjera që mund të lindin në lidhje me biznesin e grantmarrësve. Disa prej tyre shprehen se edhe nëqoftëse do të kishin shqetësime, bashkisë i mungojnë ekspertët e fushave përkatëse. Një prej të intervistuarve shprehet se ka kohë që pret të marrë lejë nga bashkia për të implementuar biznesin e tij dhe akoma nuk ka një komunikim për afatet dhe kjo përbën një vonesë në kthimin e përgjigjes. Grantmarrësit shprehen se duhet të kishte më pak procedura edhe më shumë lehtësi nga ana e dokumentacioneve.

## Pyetja 11 & 15

**11. A ka kryer bashkia monitorim ndaj biznesit tuaj? Nqs "PO" sa herë që nga hapja e biznesit?**
**15. A e keni raportuar ecurinë e biznesit tuaj pranë bashkisë Tiranë?**

Përgjigjet e dy pyetjeve më lart lidhen ngushtë me njëra-tjetrën pasi unanimisht pranohet që bashkia ka kryer monitorime të vazhdueshme pranë grantmarrësve, duke theksuar që këto monitorime kanë qënë një herë në muaj. Gjithashtu ata pranojnë se raportojnë sa herë është e nevojshme pranë sektorëve përkatës në bashkinë Tiranë për ecurinë e bizneseve. Kontakti më i shpeshtë me bashkinë është periudha e dorëzimit të faturave dhe raportimi i ecurisë financiare.

## Pyetja 14

**14.Sa zgjati proçedura e rregjistrimit të biznesit tuaj në QKR dhe në organet tatimore?**
**14.a. A hasët problem gjatë rregjistrimit të biznesit? Nqs "PO" çfarë llojë problem dhe si i adresuat ata?**

Rregjistrimi i bizneseve në QKB nuk ka zgjatur më shumë se dy ditë, duke përfshirë aplikimin për NIPT dhe aktivizimin e tij brenda 48 orëve që nga momenti i aplikimit. Vihet re se ndryshe nga bizneset ekzistuese, të cilët kanë të pakten 5 vite në treg, shohim një përmirësim dhe lehtësim të procedurave pranë zyrave të QKB. Kjo ka sjell reduktimin e pritjes në rradhë dhe aktivizimin brënda 48 orëve të NIPT të biznesit.

## 5.2 FORMATI I INTERVISTËS

# INTERVISTA

(Ndërhyrja jonë do të përfshijë monitorimin e proçesit të grantimit nëpërmjet teknikave te organizates dhe mjeteve ligjore në dispoziçion, element kyç i rëndësishëm për transparençën e vendimmarrjes se bashkisë Tiranë, monitorimin e zbatimit të granteve dhe eçurinë e tyre ekonomike dhe soçiale si dhe advokim të vazhdueshem në funksion të promovimit dhe përmirësimit të këtij proçesi dhe angazhimit të aktorëve publik që ndikojnë në këtë vendimmarrje. **Qëllimi i ketij projekti** eshte stimulimi i një proçesi transparent, të qëndrueshëm dhe të drejtë gjatë proçesit të përzgjedhjes dhe zbatimit të granteve të nxitjes së punësimit nëpërmjet monitorimit dhe rekomandimeve.)

## A ) PROÇESI I APLIKIMIT

1. Gjinia:

   - ❑ Femër
   - ❑ Mashkull

2. Mosha:

3. Si u vutë në dijeni të granteve të bashkisë?

   - ❑ Faqia zyrtare e bashkisë Tiranë
   - ❑ Nga të afermit tuaj
   - ❑ Nga stafi I bashkisë Tiranë

4. Sa transparente ishte bashkia gjatë proçesit të aplikimit?

   - ❑ Shumë transparente
   - ❑ Transparente
   - ❑ Jo shumë transparente
   - ❑ Aspak transparente

5. Gjatë proçesit të aplikimit a i jeni drejtuar bashkisë me pyetje/sqarime mbi aplikimin?

   - ❑ Po
   - ❑ Jo
   - ❑ Tjetër_____

## B ) IMPLEMENTIMI I GRANTEVE

9. Cila është fusha e biznesit tuaj?

_____

_____

10. A është e mjaftueshme shuma e investuar nga bashkia Tiranë për sigurimin e qëndrueshmërisë financiare?

_____

_____

11. A ka kryer bashkia monitorim ndaj biznesit tuaj? Nqs "PO" sa herë që nga hapja e biznesit?

_____

_____

12. A keni kontakte të shpeshta me bashkinë?

- ❑ Shumë të shpeshta
- ❑ Të shpeshta
- ❑ Disi të shpeshta
- ❑ Nuk kemi kontakte

13. A mund t'i drejtoheni bashkisë me pyetje/shqetësime në lidhje me biznesin tuaj?

_____

14. Sa zgjati proçedura e rregjistrimit të biznesit tuaj në QKR dhe në organet tatimore?

_____

_____

14.a. A hasët problem gjatë rregjistrimit të biznesit? Nqs "PO" çfarë llojë problem dhe si i adresuat ata?

_____

_____

15. A e keni raportuar ecurinë e biznesit tuaj pranë bashkisë Tiranë?

_____

_____

## Ç ) SYGJERIME/ANKESA/KRITIKA

_____

_____

FALEMINDERIT

## 5.3 FORMATI I FISHËS SË RAPORTIMIT

| Intikatori | Shpjegim | Vleresimi | Burimi i te dhenave |
|---|---|---|---|
| **Indikatori 1: Transparenca e programit** | **1= Aspak transparent - 5= Shume transparent** | | |
| Indikatori 1.1: Perdorimi i faqes zyrtare te bashkise per menaxhimin e programit | A janë publikuar të gjitha fazat e programit në faqen zyrtare të bashkise se Tiranës? | | Vleresimi i monitoruesve; monitorim i faqes zyrtare te internetit |
| indikatori 1.2: Perdorimi i medias sociale per reklamimin e programit | A janë publikuar të gjitha fazat e programit nw rrjete sociale? | | Monitorim i medias sociale te bashkise se tiranes (facebook twitter etj. |
| Indikatori 1.3: Publikimi i materialeve informuese mbi programin | Numri i personave që kanë aksesuar thirrjen për aplikime në faqen online të bashkisë dhe rrjete sociale; Numri i kërkesave për informacion, pyetje/përgjigje përmes këtyre mediumeve | | Kerkesa per informacion drejtuar bashkise |
| Indikatori 1.4: Transparenca financiare e programit | Deklarimi i shumës totale të granteve për biznesin social dhe gratë drejt sipërmarrjes; Shpallja e fituesve sëbashku me shumën e përfituar; Publikimi i fondit total të grantit – sëbashku me shpenzimet operacionale/administrative | | Monitorim i faqes zyrtare te internetit, medias sociale, kerkesa per informacion |
| Indikatori 1.5: Shpallja e tabeles pikezuese per cdo paragraf te formularit | A jane shpallur piket per cdo paragraf te formularit? | | Kerkesa per informacion drejtuar bashkise, monitorim i faqes zyrtare ne internet, media sociale |
| **Indikatori 2: Efikasiteti i menaxhimit te programit** | **1= Aspak efikas; 5= Shumw efikas** | | |
| Indikatori 2.1: Respektimi i afateve kohore te vendosura | A jane ndjekur te gjithe hapat e programit sipas afateve te publikuara nga bashkia e Tiranes? | | Intervista me pjesemarresit e programit, kerkese per informacion |
| Indikatori 2.2: Monitorimi i bizneseve nga bashkia | A monitorohen bizneset rregullisht? (Intervali kohor); Sa biznese monitorohen nga bashkia? Sa të shpeshta janë komunikimet ndermjet bashkisë dhe biznesit; A ekziston një manual për adresimin e sfidave të biznesit në fazën e implementimit | | Intervista me pjesemarresit, kerkese per informacion |
| Indikatori 2.3: Efikasiteti i sesioneve te informimit | Numri total i sesioneve informuese; Numri i pjesëmarrësve në sesionet informuese; Materialet informuese të përdorura gjatë sesionit; A janë shpërndarë forma vlerësimi pas sesionit informues? (Po/Jo); A janë pyetur aplikantët për burimin e informacionit mbi thirrjen për aplikime? | | Intervista me pjesemarresit e programit |
| Indikatori 2.4: Perberja e komisionit vleresues te aplikimeve | Cila ka qene procedura e perzgjedhjes se komisionit vleresuar? Sa transparente ka qene procedura e perzgjedhjes? Cili eshte raporti ndermjet aneatareve te brendshem e te jashtem? | | Kerkese per informacion bashkise se Tiranes |
| Indikatori 2.5: Efikasiteti i trajnimeve te zhvilluara | Sa trajnime u zhvilluan gjithsej; Respektimi i afateve kohore te trajnimeve; Efikasiteti i trajnimeve (vlerësimi i të intervistuarve: bashkia dhe përfituesit); Mbajtja e dokumentacionit nga ana e bashkisë pas zhvillimit të trajnimeve; Trajnerët e zgjedhur Sa informuese kane qene trajnimet e zhvilluara? Sa jane aftesuar pjesemarresit ne vijimin e hapjes se biznesit te tyre pas trajnimit? | | Intervista me pjesemarresit |
| Indikatori 2.6: Lehtesia e regjistrimit te biznesit | Lehtësia e regjistrimit të bizneseve – ballafaqim me kuadrin ligjor ekzistues dhe vlerësimin e Doing Business | | Intervista me pjesemarresit, ballafaqim me legjislacionin ne fuqi |
| **Indikatori 3: Qendrueshmeria financiare e programit** | **1= Aspak e qendrueshme; 5= Shumee qendrueshme** | | |
| Indikatori 3.1: Numri i vendeve te punes te krijuar nga grantet | | | Intervista me pjesemarresit |
| Indikatori 3.2: Raporti ndermjet kostove dhe perfitimeve | Sa fitimprurese kane qene bizneset ne perudhen e monitorimit? | | Intervista me pjesemarresit |
| Indikatori 3.3: Investimi nga grantmarresi ne raport me grantin | Sa thelbesor ka qene investimi i bashkise ne hapjen e biznesit? | | Intervista me pjesemarresit |
| Indikatori 3.4 Lehtesia e permbushjes se detyrimeve financiare kundrejt institucioneve publike | Sa e lehte eshte permbushja e detyrimeve financiare, taksat, siguriet etj.? | | Intervista me pjesemarresit |
| Indikatori 3.5: Perspektiva e zhvillimit te biznesit ne te ardhmen | Sa gjasa ka te zhvillohet biznesi pertej 6 muajve te pare te hapjes? | | Intervista me pjesemarresit |
| Indikatori 3.6: Perputhja e aktiviteti aktual me planin e biznesit | Sa beunk i eshte qendruar planit fillestar te biznesit? | | Intervista me pjesemarresit, kerkesa per informacion |

## 5.4 INFORGRAF

Në posterat e paraqitur më poshtë do të shfaqen rezultatet e monitorimit të Fondit te Nxitjes së Punësimit të vënë në dispozicion nga Bashkia Tiranë. Informacioni dhe analizimi i situatës do të paraqesë rezultatet për 36 perfituesit e granteve te biznesit social.






Rezultatet e monitorimit për
## 36 APLIKANTËT FITUES

**4 Grantmarrës**
**Refuzuan të japin intervistë**
duke pretenduar se nuk kanë kohë të përgjigjen

**2 Grantmarrës**
Rezultojnë të **paidentifikueshëm**
duke mos pasur adresa të sakta

Nga monitorimi rezulton se:

**1 Grantmarrës**
Dështoi pas alokimit të fazës së parë & nuk pranoi intervistën

**3 Grantmarrës**
Bëjnë pjesë dhe janë të angazhuar në forume rinore politike

Rezultatet e monitorimit për
## 36 APLIKANTËT FITUES

### MORRËN INFORMACION MBI GRANTET E BASHKISË NËPËRMJET:

**50%** janë vënë në dijeni të thirrjes për aplikim në këtë grant **nga faqja zyrtare** e bashkisë Tiranë (**facebook, media e shkruar**).

**20% pa pergjigje**

**27%** prej tyre ishin vënë në dijeni për aplikim në këtë grant **nga të afërmit e tyre.**

**3%** e grantmarrësve janë informuar nga stafi i bashkisë.

Rezultatet e monitorimit për
**36 APLIKANTËT FITUES**

## GRANTMARRËSIT U PËRGJIGJEN SE BASHKIA E TIRANËS GJATË PROCESIT TË APLIKIMIT ISHTE:

- Shumë transparente
- Transparente
- Jo shumë transparente
- Aspak transparente
- S'ka përgjigjie



**40%** mendojnë se bashkia ka qënë **shumë transparente**

**40%** mendojnë se bashkia ka qënë **transparente**

**20%** nuk jane pergjigjur

Rezultatet e monitorimit për
**36 APLIKANTË FITUES**

## GJATË PROÇESIT TË APLIKIMIT A I JENI DREJTUAR BASHKISË ME PYETJE/SQARIME MBI APLIKIMIN?

**Po 30%**

**Tjetër 3%**

**Pa Përgjigje 20%**

**Jo 47%**
nuk kanë patur pyetje drejtuar bashkisë Tiranë

## A KENI PASUR ANKESË NDAJ QASJES SË BASHKISË ME PROÇESIN?

**Po 10%**
Arsyet kryesore lidhen me aspektet administrative të aplikimit.

**Pa Pergjigje 20%**

**Jo 70%**

# FUSHA E BIZNESIT TË GRANTMARRËSVE ËSHTË E NDRYSHME.

- Dyqan animacioni dhe dekori
- Agjensi eventesh.
- Produkte artizanale
- Sherbim disagn.
- Studio fotografie
- * Sherbime audio me qera.
- * Produkte natyrale kozmetike
- Marketing Online
- Bar-Kafe. Restorant Catering
- Parukeri.
- Servis automjetesh.
- Kurse, edukim
- Qender sociale per personat me aftesi kufizuar.
- Sherbim mbi gjuhen e shenjave.
- Tregetë me pakice te artikujve ushqimor .



## SA TË SHPESHTA JANË KONTAKTET E GRANTMARRËSVE ME BASHKINË?

- 13% Shumë të shpeshta
- 50% shpeshta
- 17% Disi të shpeshta
- 20% Pa përgjigje

Grantmarrësit tregojnë se bashkia ka kryer monitorime të vazhdueshme pranë grantmarrësve

Grantmarrsit raportojnë rregullisht pranë sektorëve përkatës në bashkinë Tiranë për ecurinë e bizneseve.

Rezultatet e monitorimit për
**36 APLIKANTËT FITUES**

**Bizneset Start-Up kanë qenë para një sfide të vërtetë,** duke vuajtur mungesën e promovimit dhe klientelës

Shpesh u është dashur të **paguajnë vetë** pjesën plotësuese për blerjen e produkteve

Vlerësohet e **vështirë vazhdueshmëria** pas kalimit të gjashtë muajve të mbështetjes

Grantmarrësit **vlerësojnë grantin** e bashkisë se ka qënë një **shtysë për të hapur biznes, më shumë se sa një mundësi për të krijuar një biznes të qëndrueshëm financiarisht** në kohë

**Bizneset ekzistuese** patën **më shumë eficencë** dhe sukses për arsye se nuk u është dashur të krijojnë klientelë të re por kanë shtuar vetëm shërbimin.

# SUGJERIME NGA GRANTMARRËSIT

Mbështetja e vazhdueshme nga ana e bashkisë për bizneset që u krijuan.

Shfrytëzimi i aktiviteteve të ndryshme të bashkisë për të ftuar dhe angazhuar bizneset që ajo mbështet.

Rritja e shumës së financimit duket e domosdoshme për krijimin e një qëndrueshmërie më të lartë për bizneset e reja të nisura nga grantmarrësit

Është e nevojshme vendosja e një sistemi më korrekt pagesash (alokimi i fazave te grantit) që të shmangen vonesat e tej zgjatura nga ana e bashkisë dhe të rritet efiçensa e grantit.